



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.12.2019)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:26 dhe mbaroi në orën 09:27.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 2. Medi Bici (anëtar)*
- 3. Fatmira Luli (anëtare)*
- 4. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 5. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 6. Ilir Toska (anëtar)*
- 7. Alban Toro (anëtar)*
- 8. Brikena Ukperaj (anëtar)*
- 9. Erjon Muharremaj (anëtar)*
- 10. Marçela Shehu (anëtare)*

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Maksim Qoku: Atëherë, përshëndetje!

Sot është një mbledhje po e karakterit emergjent.

Jemi mbledhur në lidhje me vendosjen për rendin e ditës, të pikës për rifillimin e veprimtarisë të apelit administrativ të Tiranës, duke qenë që në bazë të aktit të konstatimit të lëshuar nga instituti i ndërtimit (organi kompetent) është gjykuar që ky ambient i plotëson të gjithë kushtet e funksionimit dhe nuk ka asnjë rrezik për zhvillimin e veprimtarisë në këtë godinë. Kështu që, në vijimësi edhe të vendimmarrjes së djeshme për atë pjesë gjykatash që vendosëm rifillimin e veprimtarisë gjyqësore dhe të shërbimeve gjyqësore, jemi për t’u shprehur sot edhe për Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë.

Nëse keni për të shtuar apo për të diskutuar.

Nëse nuk keni mund të kalojmë në votim.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në datën 05.12 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor